



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror
Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit
Mbledhja nr. 26
Prishtinë, më 29.06.2015, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Agim Aliu, Danush Ademi, Armend Zemaj, Donika Kadaj-Bujupi dhe Milena Miliçević.

Munguan: Fatmir Limaj, Selvi Halimi, Agim Ademaj, Doruntinë Maloku dhe Nezir Çoçaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Zahir Çerkini-praktikant në Kuvend; Hamit Mjeku-praktikant në Kuvend; Valdete Daka –KQZ; Enis Halimi –KQZ; Petrit Hysaj –OSBE; Kaltrina Ahmeti -GLPS; Dibrani Istrefi -Klan Kosova; Dukagjin Maliqi –RROKUM; Florina Merovci –ZPRK; Drilon Asllani -RADIO DUKAGJINI; Sabahudin Mema –NISMA; Tringa Bytyqi –GLPS; Adelinë Sahiti –KOSOVAPRESS; Gentiana Dushi –PRAKTIKANTE; Edi Prina –PRAKTIKANT dhe Amire Qamili –BIRN.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.05.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor i punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2014;
4. Shqyrtimi i propozimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit në Komisionin për kërkesa pronësore;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja- konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.05.2015

Kryetarja konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 13.5.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor i punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2014

Kryetarja- Pasi theksoi se anëtarët e Komisioni për Legjislacion janë njoftuar për punën e KQZ-së, përmes raportit që e kanë marrë, e kaloi fjalën te përfaqësuesit e KQZ-së që ta paraqesin raportin para Komisionit.

Valdete Daka- Theksoi se në raportin e vitit të kaluar vendin më të madh e zënë zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më 8 qershor 2014, dhe si KQZ është dashur t'i stopojmë aktivitetet e tjera me planin e veprimit të punës dhe të fokusohemi në këto zgjedhje, dihet se kur kemi zgjedhje të parakohshme të gjitha afatet ligjore të shkurtohen dhe të mbahen brenda 30 ditëve.

Kryetarja- Tha se ky raport është me i mirë se sa raportet e tjera, por janë 3 çështje që theksoi se nuk janë përfshirë në raportin e punës: E para është përfshirja e 10 mijë personave pa qenë fare shtetas të Republikës së Kosovës në LV, vetëm mbi bazën e shtetësisë së Serbisë dhe me të dhënat personale nga regjistri civil i Serbisë, e gjithë kjo ka ndodhur përmes vendimeve politike dhe dakordimeve gjatë dialogut politik. Çështja e dytë është Votimi jashtë vendit, kjo nënkupton se ky operacion ka pas qëllimin e votimit të qytetarëve që nuk janë fare shtetas të Republikës së Kosovës që të marrin pjesë në zgjedhjet në Kosovë dhe kjo ka rezultuar që shumë fletëvotime kanë ardhur nga Nishi që le të nënkuptohet se ka pasur për qëllim të mundësimin e shtetasve serbë që të votojnë. Çështja e tretë shqetësuese është çështja e numërimit dhe shpallja e rezultateve, për këtë çështje ka qenë një rekomandim nga vëzhguesit të BE-së, që një ekip të merret me procesin e votimit dhe një ekip i veçantë për procesin e numërimit, por KQZ-ja se ka marrë këtë rekomandim. Probleme të tjera kanë qenë votimi me asistencë, numri i madh i fletëvotimeve të pavlefshme, pastrimi i Listës së Votuesve.

Kryetarja- Theksoi se nuk e kuptoi mjaftueshëm nga përkthimi, por KQZ-ja ka marrë nga Nishi 25263 aplikacione! Madje këto aplikacione serbët nuk kanë pranuar t'i dërgojnë me postë sepse nuk e pranojnë Republikën e Kosovës. Andaj është dashur që KQZ-ja të shkojë e t'i marrë atje këto fletëvotime.

Agim Aliu- Theksoi se raporti tregon një pasqyrë e mirë të KQZ-së, vetëm mendoi se çështjen e raportimit duhet rregulluar, KQZ të raportoi vetëm në Komisione, e pastaj Komisionet ta shqyrtonin se a do t'i bartnim çështjet në Kuvendin e Kosovës apo jo? Është mirë që kemi pasur zgjedhje të mira dhe të pranueshme. Janë disa çështje që ne së bashku duhet të punojmë në Ligjin e ri që në të ardhmen të kemi zgjedhje edhe më të mira, Janë çështjet si Votimi me Kusht, Votimi me Postë, dhe procesi i Numërimit, Pastrimi i Listës së Votuesve, këto janë vërejtjet e mia, por përgjegjësi për këto çështje duhet të mbajnë edhe partitë politike dhe vetë qytetarët, për arsye se duhet të kontribuojnë në pastrimin e Listës së Votuesve, shembull është zgjedhja e komisionarëve sa më të mirë dhe gjatë afatit për pastrimin e listave që e shpall KQZ-ja. Ne duhet t' i lajmërojmë personat e vdekur, dhe në fund dua ta di çështjen e komisionarëve të pa paguar në zgjedhjet e fundit. A ka qenë problemi te ta në lidhje me xhirollogaritë e tyre?

Kryetarja- Theksoi se përgjegjës për pastrimin e listave është Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me KQZ-në, dhe shkaqet pse nuk është bërë pastrimi i Listave është se Partive në pozitë ju ka konvnuar që të manipulojnë me mërgatën, me komunitetet dhe personat e vdekur.

Agim Aliu- Tha se duhet bartim përgjegjësit tona sepse është një periudhë ku duhet lajmëruar personat e vdekur dhe në atë periudhë nuk kontribuojmë që të lajmojmë për personat e vdekur.

Armend Zemaj- Thekoi se këto çështje po na përcjellin nga një periudhë në një periudhë tjetër edhe pse diku me avancime e diku e njëjta çështje po vazhdon, për sa i përket raportit ky raport është më i avancuar se sa raporti i vitit 2013. Një çështje shqetësues po mbetet përpunimi i ekstraktit civil dhe puna juaj e përbashkët me Ministrin e Punëve të Brendshme dhe sapo mundet KQZ- ja që lista përfundimtare të jetë sa më shumë objektive që t'i nënshtrohet procesit zgjedhor. Lutja ime është që të keni rekomandim se kujt t'i adresohemi për këtë problem, ta dimë saktë se çfarë po bënë Ministria e Punëve të brendshme dhe çka po bëni ju si KQZ që lista përfundimtare e votuesve të jetë në harmoni me atë çfarë kërkohet! Shqetësim tjetër është informimi publik rreth procesit zgjedhor, mungojnë mekanizma të mëhershëm të vetëdijesimit të qytetarëve, jo vetëm në kohën e zgjedhjeve, dhe në fund mendoi se duhet mbetur në raport edhe Komisioni që i ka certifikuar dy palë zgjedhje se meritat apo të metat e zgjedhjeve të viti 2014 u shkojnë komisionit të vjetër së bashku me Komisionin e ri, të emëruar në fund të viti 2014. Në aspektin teknik nuk ka pasur probleme në këto zgjedhje, vetëm se duhet punuar në informimin publik sidomos të diasporës, sepse është e pa logjikshme të vijnë 10 mijë fletëvotime nga një shtet fqinj në krahasim me diku rreth 500 mijë persona kosovarë në diasporë, ku një pjesë e madhe e tyre kanë të drejtë vote në Kosovë.

Kryetarja- Tha se nuk është e njëjtë sikur qytetarët që jetojnë në diasporë e që kanë shtetësi të Kosovës, sikurse ata të vendit fqinj që nuk kanë fare shtetësi të Republikës së Kosovës, as letërnjoftim të UNMIK-ut.

Donika Kada-Bujupi- Theksi se ka vërejtje për disa çështje duke theksuar se për dallim nga vitet e kaluara ky Raport është më i plotë. Çështje e avancimit tjetër është edhe ajo e keqpërdorimit kolektiv të votës, ndërsa shqetësim është pastrimi i pjesshëm i Listave të Votuesve, ku sipas disa informatave thuhet se lisat nuk janë pastruar fare në bastionet e partisë në pushtet. Andaj dëshiroi të dijë se deri në çfarë shkalle ka mbërri ky proces? Sa për qind është pastruar Lista dhe në cilat rajone? Dhe një çështje shqetësuese është votimi me asistencë, dhe numri i madh i grave që nuk kanë votuar.

Danush Ademi- Theksoi se është shqetësuese struktura etnike e stafit të KQZ-së, ku nuk është asnjë boshnjak, goran, ashkali dhe asnjë rom, dhe një shqetësim tjetër është mos hapja e një Qendre të Votimit në një fshat të Ferizajt, ku ai fshat i plotëson kushtet për hapjen e një Qendre se ka mjaftueshëm votues.

Kryetarja- Theksoi se gjatë trajnimeve të Këshillave të vendvotimeve u është thënë se të drejtë vote kanë personat që kanë mbushur 18 vjet dhe që posedojnë dokumente të Republikës së Kosovës apo UNMIK-ut, e që e kanë emrin në Listën Përfundimtare të Votuesve. Mirëpo ditën e zgjedhjeve KQZ ka marrë vendim që të lejohen të votojnë edhe personat që nuk i posedojnë këto dokumente, fjala është për vendbanimet me serbë.

Valdete Daka- Po fillojmë me Listën e Votuesve sepse kryesisht vërejtjet i paraqitet këtu, dhe përqendrohen zakonisht në LV sepse interesi i subjekteve Politike përqendrohet te votuesit. Po flitet për 10 mijë votuesit, por dua t'ju informoj se ditën e dytë pasi që shpallen zgjedhjet nga presidenti, KQZ-ja e merr ekstraktin nga Ministria e Punëve të Brendshme, që do me thënë nuk kemi komoditet ligjor, e çfarë do qoftë tjetër, që ta heqim ndonjë votues apo ta shtojmë pa vendim të Gjykatës. KQZ, së bashku me Ministrinë e Punëve të Brendshme kanë formuar një grup punues për pastrimin e Listave të Votuesve. Ky grup ka punuar përafërsisht rreth 9 muaj, por zgjedhjet e shpeshta nga viti 2013 deri me 2014, siç janë Zgjedhjet Lokale, Zgjedhjet për Graçanicë, Mitrovicë, dhe Zgjedhjet e Parlamentare, pra këto janë arsyt që kanë ndërpre Grupin Punues për Pastrimin e Listave të Votuesve që deri më 2013. Grupi Punues ka larguar rreth 70 mijë votues që kanë vdekur, qoftë nga ata që e kanë humbur shtetësinë. Mirëpo në momentin e shpalljes së zgjedhjeve ndalohet shtimi apo largimi i votuesve nga LV. Me këto Zgjedhje të shpeshta është ndaluar edhe reforma Zgjedhore, KQZ ka dhënë rekomandimet për LV, se duhet të azhurnohet kjo listë, se si të eliminohen mundësit e manipulimeve me LV, këto dhe shumë rekomandime tjera janë marrë për t'u inkorporuar në draftin e Ligjit që ka mbetur në gjysmë. Shpresojmë që çështja e reformës nuk do të harrohet nga ana e institucioneve të Kosovës dhe do të iniciohet përsëri dhe të iniciohen brengat e subjekteve dhe qytetarëve. KQZ ka shpallur një periudhë që qytetarët t'i lajmërojnë të afërmit e tyre të vdekur me qëllim që të fshihen nga Lista e Votuesve, kurse çështja e votimit jashtë vendit është e rregulluar me ligj. Informimi publik është e vërtetë se ka qenë i shkurtër, për arsye se koha ka qenë e shkurtër, sepse ajo çka është paraparë të ndodhë brenda 6 muajve është dashur të ndodhë brenda muajit. Çështja tjetër sa i përket votimit me asistencë është e vërtetë se ka pasur një numër të madh, por duhet theksuar se ka pasur shumë pak ankesa në ZAP sa i përket votimit me asistencë dhe në përgjithësi zgjedhjeve,

Valdete Daka- Theksoi se ka qenë rekomandim i KQZ- së që të hiqet votimi me kusht për arsye se ka qenë mënyra më e shpeshtë e manipulimit dhe po ashtu votimi jashtë Kosovës të eliminohet për Zgjedhjet Lokale, kurse sa i përket numërimit edhe ne, si KQZ, kemi qenë pro që të formohen dy grupe një për procesin e votimit dhe një për numërim, por duhet pasur parasysh edhe implikimet buxhetore, ndërsa sa i përket pagesës së Komisionarëve, ka qenë se kanë pasur probleme me xhirollogaritë e tyre.

Kryetarja- Theksoi se KQZ e certifikon Listën Votuesve, andaj si është e mundur që KQZ ta certifikojë LV kur ajo listë ka pasur të dhëna të regjistrit civil të Kosovës dhe regjistrit civil të Serbisë.

Enis Halimi- Theksoi se nga viti 2000 deri më 31 dhjetor të viti 2014 janë larguar nga lista 81 311 persona, vetëm në periudhën 2013-2014 janë larguar 20 192 persona të vdekur nga Lista Votuese dhe 7 112 persona që kanë hequr dorë nga shtetësia e Kosovës.

Agim Aliu- Theksoi se çështja e Listës së Votuesve është çështje e shumë institucioneve, shembull për kontribut të pastrimit të Listave është pagesa e shërbimeve mortore nga ana e Komunave, me kusht që ta sjellin certifikatën e vdekjes e shumë e shumë mënyra të tjera, por mbi të gjitha duhet një vullnet që procesin e pastrimit të Listave ta bëjmë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Enis Halimi- Theksoi se sa i përket numërimit dhe shpalljes së rezultateve në dukje mund të ketë vonesa, mirëpo në krahasim me sistemin zgjedhor që kemi dhe llojin e votave që duhet numëruar sikurse janë votat me kusht dhe votat jashtë vendit. Ne nuk mund të kalojmë hapa dhe mendojmë se jemi në kohë, për arsye se nga procesi i numërimit deri te shpallja përfundimtare e rezultateve duhet kaluar në disa filtra siç janë verifikimi i të gjitha votave, krahasimi se a kanë votuar ata votues dy herë apo jo, dhe duhet pritur afatet Ligjore të ankesave që më pas mos të ketë kontestime. Ndërsa sa i përket fletëvotime të pavlefshme në vitin 2014 ka më pak se sa në zgjedhjet e më hershme. KQZ është në proces të hartimit të Dokumentit që ka të bëjë me trendet zgjedhore.

Donika Kada-Bujupi- Propozoi që KQZ ta sjellë një raport plotësues lidhur me metodologjinë dhe dinamikën e pastrimit të listave votuese.

Enis Halimi- Tha se mund ta bëjmë këtë raport, kurse sa i përket pastrimit nuk kam mjaftueshëm informata, sepse regjistri është qendror dhe nuk ndahet nëpër Komuna, ndërsa sa i përket çështjes së edukimit të votuesve KQZ ndanë një shumë të madhe të mjeteve për edukimin e votuesve por jemi të kufizuar në aspektin ligjor se nuk mund të fillojmë më herët përveç grupeve të caktuara siç janë grupet e të rinjve, faza e edukimit të votuesve fillon pas shpalljes së zgjedhjeve. Çështja e stafit, KQZ ka një staf të specializuar, po ashtu stafit jo permanent i kushtojmë tepër rendësi në të gjitha nivelet e administrimit të zgjedhjeve. Qendra e Votimit në Dubravë, ka pasur kërkesa për hapjen e kësaj Qendre, janë bërë analiza për hapjen e kësaj Qendre të Votimit, por nuk kemi mundur ta hapim sepse nuk ka pasur shkollë, ka ekzistuar një

objekt i CARITAS-it por me ta nuk kemi biseduar, do të shohim në të ardhmen për hapjen e kësaj Qendre, sepse KQZ i ka disa kritere për ta Hapur një Qendër të Votimit.

Danush Ademi- Tha se mos hapja e kësaj Qendre të Votimit është me qëllime të manipulimit të votuesve, sepse votuesit po duhet të shkojnë në Greme apo Komogllavë që të votojnë e gjatë rrugës për të shkuar në Qendrën e votimit në këto fshatra persona të pa ndërgjegjshëm po i manipulojnë votuesit dhe po e keqpërdorin votën e votueseve.

Agim Aliu- Tha se votimet me asistencë dhe votimet familjare do marrin ende kohë për t'u larguar duke pasur parasysh faktin se ende duhet ngritur shkalla e vetëdijes dhe emancipimit të përgjithshëm në mënyrë që të hiqen nga asistenca dhe votimet familjare, por gjithsesi për të pasur votime sa më pak të vlefshme varet se për çka votohet, zgjedhje nacionale apo lokale të kuvendit apo të kryetarit! Shohim se fletëvotime të pavlefshme ka më shumë për kuvende komunale se sa për kryetar Komune, ku kalohen edhe shifrat mbi 10 % në disa qytete, sepse vetë sistemi është i koklavitur. Mendoj se mënyra e votimit në zgjedhjet lokale të vitit 2000 ka qenë me e thjeshtë se sa 2007 e tutje, është e pakuptimtë të ketë bartës të listës për Kuvendin e Komunës. Më mirë do ishte të bëhet në njërën anë subjekti, kurse në pjesën tjetër kandidatët. Reforma zgjedhore duhet të bëhet tani, e jo të flitet vetëm në kohen e zgjedhjeve për reformën zgjedhore.

Kryetarja- Tha se reforma zgjedhore nuk është bërë për arsye që me ia zgjatur mandatin Kryetares Jahjaga, sepse nuk ka pasur vullnet politik.

Agim Aliu- Tha se për dallim të qëndrimit të Vetëvendosja për një sistem një zonal, unë jam për një sistem shumë zonal, sepse gjitha manipulimet dhe gabimet janë shumë më të vogla, e po ashtu ushtrimi i demokracisë është më i mirë, sepse ka demokraci të drejtpërdrejtë në lidhje me qytetarin.

Valdete Daka- Theksoi se sa i përket numrit më të madh të fletëvotimeve të pavlefshme gabimet më të mëdha janë te fletëvotimet për Kuvendin Komunal, ku votuesi ka bërë tik vetëm numrat e kandidatëve duke mos bërë tik fare subjektin e që nënkupton se ata kandidat nuk dihet se të cilit subjekt janë!

Kryetarja- *Pas përfundimit të diskutimeve konstatoi se në mungesë të kuorumit, votimi i raportit vjetor të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2014, shtyhet për mbledhjen e ardhshme dhe shpalli të mbyllur mbledhjen.*

Mbledhja përfundoi në orën 11:20.
E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu